

V E N D I M
Nr. 70, datë 11.2.1999

PËR EVIDENTIMIN E PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË
(Ndryshuar me VKM nr. 907, datë 19.12.2007; nr. 992, datë 2.7.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës të Shqipërisë” dhe ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çdo person, që kërkon punë ose punë të re, regjistrohet si punëkërkues i papunë në zyrën përkatëse të punësimit, për të përfutur nga shërbimet e punësimit, programet aktive të punësimit, si dhe programet e tjera shtetërore të mbështetjes me të ardhura.

2. Zyra përkatëse e punësimit vërteton të qenit i punësuar, i papunë ose punëkërkues i papunë për vetë personin ose organizmin shtetëror, të interesuar për këtë.

3. Shërbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr dhe pajis me libreza personale punësimi të tërë punëmarrësit, klientë të zyrave të punësimit dhe që e pranojnë një gjë të tillë. Në librezën e punësimit shënohen nga punëdhënësi dhe nga zyra përkatëse e punësimit marrëdhëniet e punës së mbajtësit të librezës që nga çasti i lëshimit të saj. Zyra përkatëse e punësimit shënon në librezë profesionet, specializimet, kurset e kualifikimit dhe të dhëna të tjera, që kanë të bëjnë me formimin dhe aftësitë profesionale. Libreza qëndron e depozituar te punëdhënësi gjatë tërë periudhës që vazhdojnë marrëdhëniet e punës.

Inspektorati Shtetëror i Punës vlerëson si punësim të paligjshëm çdo rast punësimi, për të cilin nuk është depozituar nga punëdhënësi librezja e rregullt e punësimit dhe e përcjell, periodikisht, këtë informacion në zyrën përkatëse të punësimit.

Librezat e punësimit kanë numër serie dhe elementë sigurie. Një personi i jepet vetëm një librezë punësimi. Publikatat për humbjen e origjinalit, dypunësim ose për arsye të tjera të pranueshme shënohen në regjistra dhe janë të ndryshme, në formë nga origjinali.

4. Zyra përkatëse e punësimit vlerëson dhe regjistron si të papunë çdo person i cili paraqitet pranë saj, deklaron se nuk është në marrëdhënie pune, nuk është i vetëpunësuar dhe që depoziton pranë saj librezën e punësimit.

Zyra përkatëse e punësimit pajis me vërtetim çdo punëkërkues të papunë, që përfiton ose do të përfitojë nga ofrimi i shërbimeve dhe programet aktive të punësimit, si edhe nga programet e tjera shtetërore të mbështetjes me të ardhura.

5. Zyra përkatëse e punësimit vlerëson dhe regjistron si punëkërkues të papunë çdo person të papunë, i cili kërkon punë dhe është i gatshëm të paraqitet sa herë që i kërkohet një gjë e tillë. Një pretendues mund të vlerësohet si punëkërkues i papunë të paktën një muaj kalendarik pas ditës së paraqitjes së tij të parë në zyrën përkatëse e punësimit për këtë qëllim.

6. Shërbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr dhe pajis me kartë personale papunësie tërë personat që pranojnë një gjë të tillë. Në kartën e papunësisë bëhet vërtetimi nga zyra përkatëse e punësimit e të qenit punëkërkues i papunë i mbajtësit të kartës. Pajisja me kartë papunësie bëhet kundrejt depozitimit në zyrën përkatëse e punësimit të librezës së punësimit dhe anasjelltas.

Karta e papunësisë përmban numër serie dhe ka elemente sigurie. Një personi i jepet vetëm një kartë papunësie. Publikatat për humbjen e origjinalit ose për arsye të tjera të

pranueshme shënohen në regjistra dhe janë të ndryshme në formë nga origjinali.

7. Personat, të cilët kundërshtojnë vende pune apo pjesëmarrje në programe të tjera shtetërore, të ofruara nga *zyra përkatëse e punësimit*, hiqen nga lista e punëkërkesve të papunë.

8. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimet në zbatim të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Inspektorati shtetëror i Punës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko